

VENDIM
Nr. 261, datë 25.3.2015

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË MJEDISIT PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË DISA
INSTITUCIONEVE PUBLIKE, PËR PAJISJEN E TYRE ME KALDAJA ME LËNDË
DJEGËSE PELET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Mjedisit, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit, në emër dhe për llogari të autoriteteve kontraktore, të përcaktuara në lidhjen nr. 1, që bashkëlidhet këtij vendimi, për pajisjen me kaldata me lëndë djegëse pelet.

2. Ministria e Mjedisit, si organi qendror blerës, të prokurorjë fondin limit të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion të përmendur në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 1 prill 2015, të dërgojnë në Ministrinë e Mjedisit, si organi qendror blerës, fondin përkatës, sipas numrit dhe tipologjisë së kaldatave, të përcaktuar në lidhjen nr. 1.

4. Ministria e Mjedisit, si organi qendror blerës, të përcaktojë specifikimet teknike, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë, për përshtatjen e kaldatave ekzistuese dhe për kaldatajt e reja.

5. Ministria e Mjedisit, si organi qendror blerës, është plotësisht përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit deri në përzgjedhjen e fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti kontraktor.

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe institucionet e përmendura në lidhjen nr. 1, bashkë-lidhur këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

LISTA E INSTITUCIONEVE QË DO TË PAJISEN ME KALDAJA ME LËNDË DJEGËSE PELET

Nr.	Institucioni (autoritet kontraktor)	Numri i kaldatave
1.	Ministria e Drejtësisë	39
2.	Ministria e Kulturës	8
3.	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	1
4.	Ministria e Punëve të Brendshme	38
5.	Ministria e Arsimit	1
6.	Ministria e Shëndetësisë	31
	TOTALI	118